



**ODA E AVOKATËVE TË KOSOVËS
ADVOKATSKA KOMORA KOSOVA
KOSOVA BAR ASSOCIATION**

Në bazë të nenit 41 para. 3.4 të Ligjit për Avokatinë Nr.04/L-193 (GZ. e Republikës së Kosovës, nr.20 datë 31 Maj 2013), me qëllim të sigurimit të nivelit të kompetencës profesionale përmes një arsimimi të vazhduar, Kuvendi i Odës së Avokatëve të Kosovës, në Mbledhjen e mbajtur më 16 Nëntor 2013, aprovon këtë:

**RREGULLORE PËR ARSIMIMIN E VAZHDUAR LIGJOR TË
OBLIGUAR PËR AVOKATË**

**Neni 1
Fushëveprimi**

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra e fitimit, llogaritjes së kredive në kuadër të AVLO-së, përgjegjësitë e Qendrës Trajnuese, sanksionet në rast të mospërbushjes të numrit të kredive dhe çështje të tjera.

**Neni 2
Përkufizimet**

Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, shprehjet e përdorura në të kanë këtë përkufizim:

1. “Aktivitet” është arsimimi ligjor i aprovuar nga Qendra Trajnuese se i përmbushë standardet për kreditë AVLO.
2. “Bartës” është individ i ose subjekti i akredituar nga Qendra Trajnuese për dhënien e kredive AVLO për aktivitetin e caktuar arsimor.
3. “Kredi AVLO” është numri i orëve të kredive për të cilat anëtari mund të pretendoj se i plotëson kushtet nga ky rregull.
4. “Avokati aktiv” është avokati i regjistruar si anëtarë i OAK-së dhe që ushtron profesionin e avokatit .
5. “Një orë kredi” nënkupton kalimin e gjashtëdhjetë minutave në një aktivitet arsimor, pa përfshirë kohën e pauzës ose të aktivitetëve tjera të cilat nuk kanë përmbajtje arsimore.
6. “Avokati joaktiv” është anëtari i regjistruar në OAK por, që nuk ushtron profesionin e avokatit për shkak të suspendimit ose pezullimit gjatë kohës së vitit raportues.

7. “Viti raportues” është viti paraprijës i datës në të cilën secili avokat duhet të vërtetoj se e ka respektuar, ka bërë përjashtime ose nuk e ka respektuar këtë rregullore.

8. “QT” nënkupton Qendra Trajnuese.

9. “AVLO” nënkupton Arsimi i Vazhdueshëm Ligjor i Obliguar.

Neni 3 Fitimi i Kredive

Kreditë fitohen përmes ndjekjes së ligjëratave, përfaqësimit falas të klientëve, ofrimit të trajnimeve, komentimit në legjislacion, shkrimit dhe publikimit të artikujve në buletin e OAK-së dhe aktiviteteve tjera të përcaktuara në këtë Rregullore.

Neni 4 Detyrimet për AVLO

1. Çdo avokat aktiv, ashtu si parashihet nga neni 6, duhet t’i ketë të kryera (realizuara) dhjetë (10) orë kredi të arsimimit të vazhduar ligjor;

2. Avokati i regjistruar për të parën herë në profesion detyrohet që deri në tri vitet e para raportuese të kyçjes në profesion, t’i ketë të kryera (realizuara) pesëmbëdhjetë (15) orë kredi të arsimimit të vazhduar ligjor gjatë secilit vit raportues.

3. Avokatët që kanë mbushur mbi 70 vite janë të obliguar të fitojnë pesë (5) orë kredi AVLO brenda një viti.

Neni 5 Lirimit nga detyrimi i përmbushjes së kredive AVLO

1. Të gjithë avokatët të cilët nuk mund ta ushtrojnë detyrën për më shumë se gjashtë (6) muaj për shkaqe shëndetësore lirohen nga detyrimi i përmbushjes së kredive.

2. Avokatët joaktivë nuk kanë nevojë t’i përmbushin kushtet nga AVLO.

Neni 6 Kushtet për kreditë AVLO

1. Orët e kredive do të llogariten bazuar në kohën aktuale të kaluar në një aktivitet. Nuk mund të fitohen kredi për asnjë aktivitet i cili nuk zgjatë së paku një orë.

2. Kreditë AVLO mund të përmbushën duke marrë pjesë në aktivitetet grupore ose duke marrë pjesë në aktivitetin alternativ.

3. “Aktiviteti grupor” është seanca e organizuar dhe e zhvilluar në grupe prej pesë ose më shumë avokatësh dhe që mund të marrë formën e ligjëratës së drejtpërdrejtë ose video-konferencës, punëtorisë, seminarit, punës praktike, orës mësimore;

4. “Aktiviteti alternativ” është një aktivitet i AVLO i zhvilluar nga avokati individual dhe mund të ngërthej, këto aktivitete si më poshtë:

4.1 Të shkruarit dhe publikimi i artikullit në Buletinet e OAK-së me përmbajtje profesionale dhe studimore; 1 (një) kredi jepet për një artikull;

4.2 Përfaqësimi falas i klientëve përmes Agjencisë për ndihmë juridike; 1 (një) kredi jepet për çdo 3 (tre) orë të përfaqësimit;

4.3 Mësimdhënia, trajnimi ose prezantimi i përmbajtjes në aktivitetin grupor ku mësimdhënësi, trajnuesi ose prezantuesi mund të fitojnë 2 (dy) kredi për secilën orë të prezantimit aktual për temën e njëjtë.

4.4 Kreditë në kuadër të AVLO-së mund të fitohen edhe përmes komentimit në legjislacion, përkatësisht, përmes dërgimit me shkrim të komenteve apo pjesmarrjes dhe komentimit në grupe punuese;

4.4.1 Avokati që paraqet komente/konkrete/e edhe substanciale/e të cilat kontribuojnë që akti normativ të jetë i kuptueshem, konsistent, përkatësisht i zbatueshem, do të përfitojë kredi;

4.4.2 Avokati që ofron koment me shkrim në një (1) akt normativ do të përfitojë 1 (një) kredi. Avokati që ofron 5 e më tepër komente me shkrim në një akt normativ përfiton 2 kredi, me kusht që të plotësohen kriteret e parapara në Paragrafin 4.4.1 të Nenit 6.

4.4.3. Tek pjesëmarrja, përkatësisht ofrimi i komenteve në Grupe Punuese, nga ky aktivitet avokati përfiton 2 kredi.

4.4.4. Komentet me shkrim, njoftimin mbi pjesëmarrjen në grup punues, avokati duhet tii dërgoj tek zyrtari përgjegjës për koordinimin e procesit të komentimit në legjislacion në OAK.

5. Jo më shumë se 40% e kredive në vit do të mund të fitohen përmes aktiviteteve alternative.

Neni 7 **Programi i AVLO-së**

1. Programi AVLO përcaktohet nga Qendra Trajnuese (me tutje QT) dhe çertifikohet nga Këshilli Drejtues i OAK.

2. Në programin AVLO së paku një 25 % kredi duhet të jenë nga etika e profesionit ligjor.

3. Një (1) orë kredi në Programin AVLO duhet të jetë nga fusha e eliminimit të paragjyimit nga profesioni ligjor, të bazuar në mes tjerash, në përkatësinë gjinore, etnike, fetare, trashëgiminë, përkatësinë kombëtare, paaftësinë fizike, moshë, ose orientim seksual.

4. QT-ja do të bëjë auditimin e bartësve për sigurimin e cilësisë.

Neni 8

Regjistrimi i kredive AVLO

1. Kreditë AVLO për secilin avokat do të regjistrohen në bazën e të dhënave të QT. Përgjegjës për regjistrim është stafi i QT.
2. QT duhet t'i ruaj listat e pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese dhe materialet e shkruara që shpërndahen lidhur me ato aktivitete. Të gjitha këto shënime duhet të mbahen nga QT tri vite nga përfundimi i vitit raportues.
3. QT-ja në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për koordinimin e procesit të komentimit në legjislacion, shqyrton komentet e bëra në aktet normative, përkatësisht verifikon nëse komentet e bëra përmbushin kriteret e parapara në Paragrafin 4.4 (4.4.1-4.4.3) të Nenit 6.
4. Në fillim të vitit pasues QT-ja publikon listën për respektimin e AVLO për vitin paraparak në faqen zyrtare të OAK-së.
5. Gjatë muajit të parë të vitit pasues, QT do tu dërgoj vërejtje gjithë avokatëve që nuk kanë përmbushur kreditë për vitin paraparak, duke i njoftuar se duhet të përmbushin obligimet deri me 31 mars të vitit pasues.

Neni 9

Sanksionet në rast të mosrespektimit

1. Në bazë të raportit të QT, Drejtori Ekzekutiv i OAK të gjithë avokatëve që nuk kanë përmbushur obligimin për vitin paraparak edhe pas periudhës nëntëdhjetë (90) ditore përkatësisht pas datës 31 mars të vitit vijues, i shqipton gjobën në vlerë prej 300 euro.
2. Afati për pagesë të gjobës është 30 ditë nga data e shqiptimit të gjobës.
3. Gjatë vitit të ardhshëm raportues, avokati kundërvajtës duhet të ndërmerr masat për përmbushjen e kushteve vjetore për vitin paraparak raportues dhe ta dorëzojë vërtetimin mbi respektimin e AVLO për atë vit së bashku me plotësimin e kushteve të tija vjetore për periudhën aktuale të raportimit duke e dorëzuar edhe vërtetimin përkatës mbi respektimin e AVLO-së për atë vit.
4. Nëse sipas raportit të QT, pas kalimit të afatit shtesë prej nëntëdhjetë ditëve nga dita e vitit raportues, verifikohet se avokati ka dështuar në përmbushjen e kredive të AVLO-së për dy vite, Këshilli Drejtues i OAK e pezullon licencën e avokatit.
5. Avokati mund ta rifitojë të drejtën e ushtrimit të avokaturës pas përmbushjes së plotë të kërkesave arsimore për dy vite dhe pas pagesës së tarifës përkatëse për kthim në vlerë prej 1.000,00 Euro, në të cilin rast Këshilli Drejtues e rikthen licencën avokatit në fjalë për ushtrimin e avokatisë.

Neni 10

Standardet për aktivitetet AVLO

Standardet për aktivitetet e AVLO do-së do të përcaktohen nga Rregullorja për QT të OAK.

Neni 11

Përgjegjësitë e bartësve të AVLO

Secili bartës duhet:

1. Të mbajë të dhënat mbi pjesëmarrjen duke përfshirë këtu emrat e pjesëmarrësve, nënshkrimet dhe ti dërgoj ato në QT;
2. Ta vë në dispozicion aktivitetin për secilin avokat i cili regjistrohet, pjesëmarrja mund të kufizohet në mënyrë që t'i përshtatet objektit, por që përparësi duhet tu jepet atyre që regjistrohen ose që paraqiten të parët.

Neni 12

Aprovimi i bartësve të aktiviteteve të shumëfishta të AVLO

1. Aktivitetet e ofruara nga bartësi i aprovuar për shumë aktivitete AVLO ,aprovohen automatikisht për kreditë AVLO me kusht që sponsori siguron se aktiviteti i plotëson standardet e përcaktuara nga QT sipas nenit 10të kësaj Rregullore.

2. Bartësi do të konsiderohet si bartës i aktiviteteve të shumëfishta me kusht që të jetë në Listën e bartësve të aktiviteteve të shumëfishta të cilën e ka e miratuar paraprakisht QT. QT mund të konsiderojë metoda tjera të aprovimit të bartësve të aktiviteteve të shumëfishta, duke përfshirë propozimin që Kërkesa mund të paraqitet për aprovim si aktivitet i shumëfishtë i AVLO duke ia paraqitur formën përkatëse QT, pagesën e shumës së kërkuar dhe demonstrimin se brenda periudhës dyvjeçare aplikuesi ka marrë aprovimin nga QT për katër aktivitete të ndryshme AVLO dhe i ka mbajtur ato në katër data të ndryshme.

3. Aprovimi i bartësit të arsimimit të vazhduar ligjor mund të revokohet nga komiteti nëse:

- 3.1 Nuk janë respektuar kërkesat (kushtet) e raportuara nga ky rregull;
- 3.2 Nëse përmbajtja e kursit ose cilësia është nën standardin e kërkuar për aktivitetet e arsimimit të vazhduar ligjor të përcaktuar nga QT ashtu siç parashihet me këtë rregull;
- 3.3 Bëhet prezantim i rrejshëm në kërkesën për aprovim të statusit të bartësit ose në kërkesën për aprovim të aktivitetit për arsimim të vazhduar ligjor;
- 3.4 Nuk respektohet cilado nga kushtet e QT.

4. Për ripërtëritjen e aprovimit, bartësi i aprovuar i aktiviteteve të shumëfishta duhet:

- 4.1 Të aplikoj për ripërtëritje duke plotësuar formularin e QT për ripërtëritjen e statusit të bartësit të shumëfishtë;
- 4.2 Të paraqesë dëshmi se i ka ofruar katër aktivitete të ndryshme të cilat i përmbushin kushtet nga ky rregull brenda dy vjetëve paraprijëse të kërkesës për ripërtëritje.

5. Ripërtëritja e aprovimit për bartësit nga lista paraprake e listës së bartësve duhet të shqyrtohet në baza vjetore nga QT.

6. Kur aktiviteti i arsimimit të vazhduar ligjor është i aprovuar dhe ofrohet nga bartësi i aprovuar, ky i fundit mund të shpallë në broshurat e veta dhe/ose materialet për regjistrim se: *"Ky program është i aprovuar nga Qendra Trajnuese e OAK, për orët e arsimimit të vazhduar ligjor."*

Neni 13
Aprovimi i aktivitetit individual

Bartësi i cili nuk është aprovuar për aktivitete të shumëfishta mund të kërkojë aprovimin e kurseve individuale ose aktiviteteve duke dorëzuar kërkesën përkatëse të aktivitetit individual AVLO dhe pagesën përkatëse para ose deri tridhjetë (30) ditë nga data e aktivitetit. Në rastet kur aprovimi nuk është bërë para mbajtjes së aktivitetit, duhet t'u bëhet me dije të gjithë pjesëmarrësve se kërkesa për aprovim të kredive nuk është aprovuar ende.

Neni 14
Financimi i AVLO

Avokati do ta paguaj shumën prej 50 EUR në vit të pagesës për AVLO në fillim të vitit kalendarik e jo me vonë se data 31 Janar, që do të shfrytëzohet ekskluzivisht për administrimin e sistemit AVLO ashtu si përcaktohet nga QT. QT do ta shqyrtojë çdo dy vjet lartësinë e kësaj takse.

Neni 15
Raportimi

QT i raporton në baza vjetore Këshillit Drejtues të OAK mbi implementimin e kësaj Rregullore.

Neni 16
Hyrja në fuqi dhe veprimi

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e aprovimit në Kuvendin e Odës së Avokatëve të Kosovës dhe zbatohet nga data 01 Janar 2014.

Av. Ibrahim Z. Dobruna
Kryetar i OAK-së